

KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Periudha raportuese	Gusht, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Blerta Basholli, drejtore e Drejtorisë, Lindita Hajdare, shefe e Sektorit për kulturë

1.PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Sektori i Kulturës

Gjatë muajit gusht janë realizuar shumë takime dhe aktivitete të planifikuara dhe të paplanifikuara me partnerë, me institucione dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare, bazuar në planin e punës.

Drejtoria e Kulturës dhe institucionet vartëse, kanë realizuar planin operativ të punës, si dhe angazhime të tjera sipas nevojës.

Shënim (pjesa më e madhe e takimeve qoftë me institucione, qoftë me individë, është mbajtur përmes platformës digjitale ZOOM, për shkak të pandemisë COVID -19, gjithashtu edhe takime fizike sipas nevojës.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj.

Sektori i Kulturës

- Takimet me ekspertë të ndryshëm për Muzeun e Qytetit të Prishtinës;
- Planifikimi i implementimit të projektit “Hapja e sondave” në ish-bibliotekën “Hivzi Sulejmani”;
- Inicimi, koordinimi i aktiviteteve të prokurimit sipas planit të prokurimit dhe atij buxhetor;
- Planifikimi i takimeve me institucionet relevante lidhur me Kulturën ,Trashëgiminë kulturore, si dhe promovimin e turizmit, ministritë relevante, organizata etj.

Përcjellja e punimeve përgjatë implementimit të kontratës në strehimoren e artit (Bregu i Diellit);

- Koordinimi i punëve rreth kërkesave dhe nevojave administrative dhe ligjore me drejtoritë përkatëse, si dhe me Zyrën e prokurimit dhe Zyrën ligjore;
- Adresimi i kërkesave në shtab për dhënie të pëlqimeve për shfrytëzim të hapësirës;
- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore;
- Kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara;
- Përgatitja e raportit mujor; Përgatitja e kontratave dhe vendimeve të shqyrtimit të ankesave të fazës së parë;
- Përgatitjet e draft detyrës projektuese për adaptimin, ruajtjen dhe restaurimin e ish-bibliotekës “Hivzi Sulejmani” për Galeri të qytetit;
- Takimet e vazhdueshme me përfaqësues të Manifestës.

TQP “Dodona”

Komunikimi me organizatën partnere OJQ “Fondacioni për të drejtat e kafshëve” për realizimin e shfaqjes për fëmijë “Teo, qeni i rrugës”, i cili ka fituar subvencion nga Komuna e Prishtinës, Komunikimi me donatorët potencialë dhe palë të ndryshme,

Përgatitjet për sezonin e ri teatror, që pritet të fillojë në shtator, 2020.

Qendra Kulturore e Fëmijëve

- Zhvillimi i takimeve të rregullta;
- Pjesëmarrja në Festivalin “Luajmë dhe vallëzojmë”, Durrës, Shqipëri (Online);
- Përgatitja për pjesëmarrje të grupit të valltarëve në festivalin “Damestion”;
- Përgatitjet për festivalin “Ylberi i Prishtinës”

Arkivi i Qytetit

- Rregullimin e materialit nga Drejtoria e Pronës.

Biblioteka “Hivzi Sulejmani”

- Përpunimi fizikë i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj;

- Shërbimi me lexues;
- Huazimi i librit;
- Përgatitja dhe planifikimi i programit të punës për vitin 2020;
- Mirëmbajtja e ueb-faqes së bibliotekës.

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:

- Implementimi i projektit “Hapja e sondave në ish-bibliotekën “Hivzi Sulejmani”, si dhe përfundimi i procedurave administrative;
- Realizimi i takimeve dhe koordinimi i punëve rreth përgatitjeve për formimin e grupit punues për Muzeun e Qytetit të Prishtinës;
- Vizitat në terren nga organi mbikëqyrës dhe zyrtarë të drejtorisë për implementimin e kontratës, e cila është në përfundim të punimeve, në Strehimoren e Artit (Bregu i Diellit);
- Përfundimi i vlerësimit të aktivitetit “Furnizim me Libra”;
- Mbikëqyrja dhe përcjellja e aktivitetit “Shërbimet konsulente” nga organi mbikëqyrës;
- Përgatitjet procedurale për implementimin e aktivitetit “Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për ngritjen e sigurisë së lëndës arkivore, në arkivin e Prishtinës”;
- Përgatitjet dhe koordinimi i punëve me institucionet vartëse për inicimin e procedurës së prokurimit “Furnizim dhe montim me pajisje për institucionet vartëse të Drejtorisë së Kulturës”;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi me NPB rreth kërkesave dhe nevojave nga institucionet vartëse, lidhur me renovimet emergjente dhe mirëmbajtjen e institucioneve vartëse;
- Koordinimi i punëve me ekspertë të fushës, rreth përgatitjes së draftdetyrës projektuese për ish-bibliotekën “Hivzi Sulejmani”;
- Janë mbajtur takime virtuale me përfaqësuesit e Manifestës, lidhur me çështjet: shtimi i numrit të anëtarëve të bordit, buxhetit dhe përgatitjes së hapjes së konkurseve për staf “Manifesta 14, Prishtina”;
- Takime me artistë dhe profesionistë të fushës për hapjen e thirrjes për punësim në “Manifesta 14, Prishtina”, për koordinator gjeneral.

- Bashkëpunimi me Kabinetin e Kryetarit për rregullimin e dokumentacionit shtesë, të kërkuar pas fitimit të grantit “Creative Europe”;
- Kontakti me bankën “Procredit”, ku është e hapur llogaria e Manifestës, është kërkuar shërbimi e-banking, ku është shtyrë takimi për në mes të shtatorit, për shkak të stafit të reduktuar ne banka;
- Adresimi për shtab i kërkesave për dhënie të pëlqimeve për shfrytëzim të hapësirës;
- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore;
- Kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara;
- Shkarkimi i lëndëve nga Intraneti;
- Përgatitja e kontratave dhe vendimeve të përfutuesve dhe komisionit të ankesave;
- Adresimi i kërkesave drejtorisë përkatëse rreth lejes për Parkun e aventurave, vendosjen e veprës së Sislej Xhafës, si dhe kërkesa tjera sipas nevojave të drejtorisë;
- Pjesëmarrje në ekspozitën e Jakup Ferrit në Galerinë e Arteve;
- Asistimi i Marieke Van Hal nga Manifesta, për gjetjen e partnerëve për bashkëpunim, për projektpozimin e ri, ku është krijuar partneritet me dy organizata “CIVIKOS” dhe “Germin”, titulli i projektit “Manifesta 14, Prishtina”: “Creating Common European Ground”.

TQP “Dodona”

- Komunikimi me organizatën partnere OJQ “Fondacioni për të drejtat e kafshëve” për realizmin e shfaqjes për fëmijë “Teo, qeni i rugës”, i cili ka fituar subvencion nga Komuna e Prishtinës;
- Komunikimi me donatorët potencialë dhe palë të ndryshme.

Qendra Kulturore e Fëmijëve

- Organizimi i punëve me staf të reduktuar të QKF-së për shkak të pandemisë.

Arkivi i Qytetit

- Rregullimin, klasifikimin dhe evidentimin e lëndës arkivore;
- Skenimi dhe digjitalizimi i disa projekteve të ndërtesave në Prishtinë.

Biblioteka “ Hivzi Sulejmani”

Nga data 15.07.2020, puna ka filluar me orar të plotë, 8:00 – 16:00, në huazim të librit, duke respektuar të gjitha masat e parapara nga ISHPK;

Edhe gjatë muajit gusht kemi vazhduar punën në huazimin e librit, ndërsa sallat e leximit ende janë të mbyllura për lexues.

Kryhen këto shërbime:

- Huazimi i librit,
- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare,
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit,
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj,
- Huazimi i librit,
- Përgatitja e raporteve mujore,
- Mirëmbajtja e ueb-faqes së bibliotekës.

AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

Sektori i kulturës:

- Vazhdimi i përgatitjeve komform protokollit të “Manifesta 14”, Bienale Evropiane e Artit Bashkëkohor;
- Parapërgatitjet dhe koordinimi me organin mbikëqyrës për fillimin e implementimit të aktivitetit “Revitalizimi i rrugës “Mehmet Kaçurri”” (rrugës Model);
- Konkurs “Projektimi për konservimin dhe adaptimin e shtëpisë shkollë në Muzeun e shtëpive shkolla, (Lagja e Herticëve, Prishtinë), vazhdimi i procedurave administrative pas pranimin të projektit zbatues;
- Ndërtimi i Qendrës kulturore për të rinj - Bibliotekës në lagjen ”Kodra e Trimave”, në pritje të vendimit nga OSHP;
- Rregullimi i ambientit për ekspozimin e veprave të artit, janë duke u zhvilluar punimet, priten të përfundojnë gjatë muajit shtator;
- Fillimi i implementimit, sipas kontratës për aktivitetin “Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për ngritjen e sigurisë së lëndës arkivore në Arkivin Komunal të Prishtinë;

- Aktiviteti “Furnizim me libra”, është bërë vlerësimi, në pritje të afatit kohor të ankesave;

- Renovimi i bibliotekës “Hivzi Sulejmani”, degës “Përkujtimorja” në Taukbahçe, është bërë vlerësimi, në pritje të përfundimit të afatit kohor të ankesave;

Draft detyra projektuese për Galerinë e qytetit, takimi me artistë, është në implementim e sipër.

TQP “Dodona”

- Komunikimi me organizatën partnere OJQ “Fondacioni për të drejtat e kafshëve”, për realizmin e shfaqjes për fëmijë “Teo, qeni i rrugës”, i cili ka fituar subvencion nga Komuna e Prishtinës,
- Komunikimi me donatorët potencialë dhe palë të ndryshme.

Qendra Kulturore e Fëmijëve

- Përgatitje dhe xhirimi të sektorit të valleve për pjesëmarrje në festivalin “Damestion” Kosovë;
- Pjesëmarrja në Festivalin “Damestion”,
- Përgatitje për Festivalin “Ylberi i Prishtinës 2020”.

Arkivi i Qytetit

- Rregullimi i materialit arkivor, fondi “Komuna e Prishtinës – Drejtoria e Pronës”;
- Skenimi dhe digjitalizimi i objekteve të ndryshme në komunën e Prishtinës.

Biblioteka e qytetit “Hivzi Sulejmani”

- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj;
- Huazimi i librit;
- Përgatitja e raporteve;
- Mirëmbajtja e ueb-faqes së bibliotekës.

Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

Takimet me palë

- Takime me qytetare/palë/ organizata /institucione vartëse, sipas kërkesave dhe udhëzimeve nga drejtoria lidhur me kërkesat e drejtorisë.

Takimet me institucione të tjera

Sektori i kulturës

Takime me përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës, përfaqësues të Manifestës, takime me artistë, përfaqësues të institucioneve, operatorë ekonomik të cilët kanë kontrata të hapura që ka drejtoria, NPB etj.

Arkivi i Qytetit

Takime me përfaqësuesit e Komunës së Prizrenit në lidhje me marrëveshje bashkëpunimi, me theks të veçante për mundësinë e krijimit të një katalogu të ngjashëm siç e ka bërë Arkivi Komunal i Prishtinës.

Diskutime publike / Takimet me qytetarë

Në muajin gusht janë hapur diskutimet publike për qytetarë përmes platformës digjitale.

6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

Drejtoria e Kulturës konform legjislacionit, çdo herë u është përgjigjur kërkesave për qasje në dokumente zyrtare.

Arkivi i Komunal i Prishtinës

- Gjatë muajit gusht 2020, kemi pasur gjithsej 31 kërkesa, të cilave iu kemi përgjigjur brenda afateve ligjore.

Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

Në muajin gusht 2020, në Drejtorinë e Kulturës janë pranuar gjithsej 18 lëndë, të cilat janë shqyrtuar dhe adresuar sipas natyrës së lëndës.

Takime të tjera

SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

Arkivi i Qytetit

- Gjatë implementimit të planit po hasim në vështirësi të mëdha si pasojë e pandemisë COVID – 19, si dhe mungesës së stafit, sidomos në shërbimin e rregullimit të lëndës arkivore. Andaj po e cekim se kemi nevojë të madhe për së paku 3 punëtor/e.

REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.

Qendra Kulturore e Fëmijëve

Janë bërë kërkesa me specifika për:

- furnizim me pajisje për inventarë;
- blerje të ndriçimit;
- Tepison për zyra;
- Kërkesë për veshje për valltarët e vegjël, femra dhe meshkuj (6 – 12 vjeç);
- Kërkesë për kondicioner për zyra dhe sallën e ushtrimeve (nxehje- ftohje);

- Kërkesë me zërimi.

Arkivi i Qytetit të Prishtinës

- Rekrutimi i stafit në trajnime të ndryshme, të cilat kanë karakter për ngritjen e cilësisë profesionale.

Biblioteka “Hivzi Sulejmani”

- Të rekrutohen punëtorë të rinj;
- Të shtohen 150 tavolina dhe 150 karrige;
- Renovimi i tualeteve;
- Zgjidhja e problemit me rrymë dhe vendosja e dritave të neonit në objektin e ri;
- Renovimi i objektit në degën “Pallati i Rinisë”;
- Renovimi i objektit në degën “Përrallat” dhe “Lëtyra”.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

Spektori i kulturës

- Planifikimi i thirrjes publike për subvencione, faza e dytë;
- Përcjellja e të gjitha aktiviteteve të iniciuara nga drejtoria me kontrata të hapura, si dhe ato të cilat fillojnë me implementim;
- Monitorimi i punës së institucioneve vartëse;
- Shqyrtimi i lëndëve dhe kërkesave.

TQP “Dodona”

- Komunikimi me organizatën partnere OJQ “Fondacioni për të drejtat e kafshëve” për realizimin e shfaqjes për fëmijë “Teo, qeni i rrugës”, i cili ka fituar subvencion nga Komuna e Prishtinës;

- Komunikimi me donatorët potencialë dhe palë të ndryshme;
- Në rast të lejimit të punës së teatrove që janë ndaluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për shkak të pandemisë, do të bëhen përgatitjet për sezonin e ri teatror, si dhe do të bëhet realizimi i programit mujor të shfaqjeve në TEATRIN PËR FËMIJË dhe SKENËN E MBRËMJES, si dhe promovimi i tyre në rrjetet sociale.

Qendra Kulture e Fëmijëve

- Organizimi i festivalit “Ylberi i Prishtinës 2020“;
- Dezinfektimi dhe dezinfektimi i QKF –së.

Arkivi i Qytetit të Prishtinës

Vazhdimi i rregullimit të fondit të Komunës së Prishtinës, Drejtoria e Pronës.

Biblioteka “ Hivzi Sulejmani”

- Aktivitetet për realizimin e projektit “Dita ndërkombëtare e librit për fëmijë”, i mbështetur nga subvencionet e Komunës së Prishtinës: shpallja e konkursit letrar dhe shpërndarja nëpër shkolla, shpallja e punimeve më të mira dhe botimi i librit me punimet e nxënësve të shkollave të Prishtinës;
- Aktivitete të ndryshme, në bashkëpunim me Qendrën “LIBART”, e cila realizon projekte që kanë të bëjë me librin;
- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj;
- Huazimi i librit;
- Përgatitja e raporteve mujore.

TË TJERA - Shënimi çështje të tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

Arkivi i qytetit

Arkivi i Prishtinës në muajt në vazhdim, do të merret edhe me mbikëqyrjen e projektit, që cili do të fillojë implementimi në muajin shtator, projekti do të jetë “Siguri e lëndës arkivore në Arkivin Komunal të Prishtinës.